



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS I.

Numri i lëndës: 2022:184295

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04962352

PPP.nr.65/2018

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA I., Departamenti i Pergjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (Kek) Sh.A, Rruga “Nëna Terezë”, numër 36, Prishtinë, ndaj debitorit M.B, nga fshati K., Komuna I., nga baza juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.612/2018 i datës 20.12.2018, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit M.B, nga fshati K., Komuna I., i parashtruar kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.612/2018 i datës 20.12.2018.

II.SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.612/2018 i datës 20.12.2018.

A r s y e t i m

Kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (Kek) Sh.A me seli në Prishtinë, me datë 20.12.2018, ka parashtruar propozim për lejjimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 09.01.2007 deri me datën 20.03.2013, baza juridike borxh në vlerë prej 893.91 €.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrin P.nr. 612/2018 të datës 20.12.2018, ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datë 24.12.2018 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, duke theksuar se borxhi të cilin e kërkon kreditori, është borxh i paguar dhe i parashkruar.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka propozuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi, duke shtuar se debitori me datën 29.08.2016, ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaruaë mbi dakordimin e borxhit, ndërsa me datën 13.03.2018 ka bërë pagesën e energjisë elektrike për KEK- kësti 9, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve, mirëpo debitori ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ, nr 04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike dhe si i tillë për shkak të mospagesave të 1 kësteve, vlera e falur e borxhit i është rikthyer, ndërsa pagesat e bëra në emër të pagesa e bërë në emër të pagesës së energjis me këste, i është minusuar në vlerën e përgjithshme të borxhit. Tutje ka shtuar se kërkesa për prapësim, nuk është në harmoni me nenin 69, paragrafin 4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e pales debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera te lëndës, ka gjetur se prapësimi është në tërësi i bazuar.

Në propozimin për përmbarim të datës 20.12.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri me Urdhrin P.nr.612/2018, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 09.01.2007 deri me datën 20.03.2013.

Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit gjen se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, duke u bazuar në nenin 360 të LMD, paragrafët 1, nën paragrafi 1.1., 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë; 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.* Gjykata gjen se, në bazë të ekstraktit nga librat afarist, debitori nga data 09.01.2007 e deri më 23.12.2007 ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 462.77 €, kurse ka bërë pagesa në vlerë 104.00 €, e që vorgji i mbetur në vitin 2007 është në vlerë prej 358.77 €. Në vitin 2008 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 423.32 €, kurse nuk ka bërë pagesë të energjisë elektrike, e që borxhi i mbetur për vitin 2008 është 423.32 €, Në vitin 2009 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 433.53 dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 190.00 € e që borxhi i mbetur për vitin 2009 është 243.53 €. Në vitin 2010 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 205.06 € dhe ka bërë fare pagesë në vlerë prej 150 €, e që borxhi i mbetur për vitin 2010 është në vlerë prej 55.06 €. Në vitin 2011 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 163.53 € dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 113.00 €, e që borxhi i mbetur për vitin 2011, është në vlerë prej 50.53 €. Në vitin 2012 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 187.92 € dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 50.00 €, e që

borxhi i mbetur për vitin 2012, është në vlerë prej 137.92 €. Në vitin 2013, nga data 14.01.2013 deri me datën 20.03.2013 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 52.40 € dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 40.00 €, e që borxhi i mbetur për vitin 2013, është në vlerë prej 12.40 €.

Sipas vlerësimit të gjykatës borxhi i kërkuar nga kreditor është i parashkruar, pasi që afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Së këndejmi, borxhi i vitit 2007 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2007, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2008, borxhi i vitit 2008 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2008, ndërsa është parashkruar me datën 31 dhjetor 2009, borxhi i vitit 2009 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2009, ndërsa është parashkruar me datën 31 dhjetor 2010, borxhi i vitit 2010 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2010, ndërsa është parashkruar me 31 dhjetor 2011, borxhi vitit 2011 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2011, ndërsa është parashkruar me 31 dhjetor 2012, borxhi i vitit 2012 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2012, ndërsa është parashkruar me datën 31 dhjetor 2013 dhe borxhi i vitit 2013 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2013, ndërsa është parashkruar me 31 dhjetor të vitit 2014, kurse përmbartimi është lejuar me datën 20.12.2018. Rrjedhimisht, gjykata duke u bazuar në këto gjetje, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lidhur me pretendimin e kreditorit si në përgjigje në prapësim, se debitori me datën 29.08.2016, ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaratë mbi dakordimin e borxhit, ndërsa me datën 13.03.2018 ka bërë pagesën e energjisë elektrike për KEK- kësti 9, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve, gjykata konstatoi se kreditori propozimit për përmbartim nuk i kishte bashkangjitur këto prova, përkatësisht kontratën për pagesën e borxhit si dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit, prandaj sipas vlerësimit të gjykatës, pavarësisht se në ekstraktin nga librat afariste, rrjedh se debitori ka bërë pagesë të energjisë elektrike me 9 këste në shumën nga 20.00 €, për periudhen nga data 09.09.2016 deri me datën 13.03.2018, por në shkresat e lëndës nuk ekzistonin provat, konkretisht, kontrata për pagesën e borxhit si dhe deklarata mbi dakordimin e borxhit të cilat argumentonin faktin që pagesa e kësteve ishte bërë sipas marrëveshjes, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës pagesa e këstit mund të bëhet vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara dhe si rrjedhojë, gjykata erdhi në përfundim se borxhi i debitorit rezulton të jetë i parashkruar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të parashtruara nga palët, por ishin pa mdikim për vendosje ndryshe në këtë çështje.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.65/18, me datë 23.11.2023

Gj y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.